



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
MINISTRI

URDHËR

Nr. 4895 / 4, datë 01/11/2016

PËR

**MIRATIMIN E FORMATEVE TË LISTAVE TIP TË DOKUMENTEVE GJYQËSORE QË  
ARKIVOHEN NGA GJYKATAT**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, të nenit 7, pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat", si dhe pikës 8 të VKM nr. 903, datë 17.12.2014, "Për krijimin e Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor", me propozim të Drejtorit të Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor,

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e formateve të listave tip të dokumenteve gjyqësore që arkivohen nga gjykatat, sipas Anekseve bashkëlidhur dhe që janë pjesë përbërëse e tij.

2. Lista tip përcakton afatet e ruajtjes së dokumenteve dosjeve, regjistrave dhe dokumenteve gjyqësore që arkivohen nga gjykatat, të kategorizuara si më poshtë:

- Aneksi 1 – Lista tip e dosjeve gjyqësore të çështjeve civile
- Aneksi 2 - Lista tip e dosjeve gjyqësore të çështjeve penale
- Aneksi 3 - Lista tip e dosjeve gjyqësore të çështjeve administrative
- Aneksi 4 - Lista tip e dosjeve gjyqësore të çështjeve tregtare
- Aneksi 5 - Lista tip e dosjeve gjyqësore të gjykatave të apelit të depozituara në gjykatat e shkallës së parë
- Aneksi 6 - Lista tip e dosjeve gjyqësore të menaxhimit të çështjeve

3. Urdhëri nr. 2583/12, datë 16.09.2009, i Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e listës tip të dosjeve dhe regjistrave, të gjykatave të shkallëve të para dhe të apeleve, me afatet e ruajtjes së tyre”, shfuqizohet.

4. Ngarkohen gjykatat për zbatimin e këtij urdhëri.

5. Ngarkohet Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor për ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**

**YLLI MANJANI**



**DOSJET E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE CIVILE**

<b>Nr. i Serisë</b>	<b>Titulli i Serisë së Dosjes</b>	<b>Periudha e Ruajtjes</b>
1-001	Trashëgimia	Përhershëm
1-002	Atësia	Përhershëm
1-003	Birësimi	Përhershëm
1-004	Padi pronësie, uzurfrukti, servituti, kërkim sendi, posedimi, trashigimi, shkaktim dëmi, begatim pa shkak, pagim i pa detyruar, zgjerimi i punëve të tjetrit, kontrata të shitjes, pjesëtim pasurie	Përhershëm
1-005	Padi kontratuale të tjera Të gjitha çështjet e tjera civile dhe familjare	20 vjet
1-006	Padi kundërshtëmi veprimi përmbarimor dhe dosje të tjera civile (çështje të pushuara, kërkesa, kërkesa autorizimesh etj.)	15 vjet

**Shënim:**  
Çdo dosje në të cilat trashëgimia, atësia, birësimi apo të drejtat dhe pronësia mbi pasuritë e patundshme ndikohen nga vendimi penal ruhen përgjithmonë.



**DOSJET E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE PENALE**

Nr. i Serisë	Titulli i Serisë së Dosjes	Periudha e Ruajtjes
2-001	<p>Çështje penale ku është dhënë dënimi të përjetshëm</p> <p>Çështjet penale që për shkak të specifikës paraqesin rëndësi historike kombëtare (pavarësisht nga masa e dënimit të dhënë në vendimin gjyqësor) si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Çështjet penale për krime kundër shtetit;</li> <li>- Çështjet penale për krime kundër njerëzimit;</li> <li>- Çështjet penale që lidhen me aktet terroriste;</li> <li>- Çështjet penale ku subjekte të veprës penale janë funksionarëve të lartë shtetërorë, funksionarë të sistemit gjyqësor, të zgjedhur vendorë, nëpunës publikë vendas dhe të huaj, persona që ushtrojnë funksione publike,;</li> <li>- Çështje penale që kanë të bëjnë me pavarësinë dhe rendin kushtetues, sekretin shtetëror</li> </ul>	Përherëshëm
2-002	Çështje penale në të cilat është dhënë dënimi maksimal me burgim mbi 15 deri në 30 vjet	30 vjet – 45 vjet
2-003	Çështje penale në të cilat është dhënë dënimi maksimal me burgim mbi 10 deri në 20 vjet	20 vjet – 35 vjet
2-004	Çështje në të cilat është dhënë dënimi maksimal me burgim mbi 5 deri në 10 vjet	10 vjet - 25 vjet
2-005	<p>Çështje penale në të cilat është dhënë dënimi maksimal deri në 5 vjet burgim</p> <p>Çështje penale në të cilat është dhënë dënimi maksimal deri në 5 vjet burgim dhe</p>	5 vjet – 10 vjet

Nr. i Serisë	Titulli i Serisë së Dosjes	Periudha e Ruajtjes
	<p>me gjobë</p> <p>Çështje penale në të cilat është dhënë dënimi me gjobë</p> <p>Çështje penale në të cilat është dhënë pafajësi</p> <p>Çështje penale në të cilat është vendosur pushimi i çështjes</p> <p>Çështje penale në të cilat është vendosur zëvendësimi i dënimit me burgim me pagimin e një shume të hollash në favor të shtetit</p>	
2-006	<p>Kërkesa penale:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ulje dënimi</li> <li>- Konvertim dënimi</li> <li>- Ekzekutim letërporosie</li> <li>- Ndrejje gabimi</li> <li>- Kundërshtim vendimi i prokurorisë</li> <li>- Rekomandim, kërkesa mase mjekësore</li> <li>- Rivendosje e afatit të ankimit</li> <li>- Mosdhënie e mjeteve për jetesë</li> <li>- Ankim kundër procedimit penal</li> <li>- Ekstradimi</li> <li>- Pezullim vendimi</li> <li>- Dhënie amnistie</li> </ul>	5 vjet
2-007	Kundravajtje penale për të cilat është dhënë dënimi me burgim	5 vjet
2-008	Kundravajtje penale për të cilat është dhënë dënimi me gjobë	3 vjet
<p><b><u>Shënim:</u></b></p> <p><b>Kriter përcaktues ne numrin e serise në dosjet penale është dënimi maksimal i parashikuar në kodin penal për veprën penale të kryer.</b></p> <p><b>Në rastin kur i dënuari ka kryer më shumë se një vepër penale kriter përcaktues për numrin e serisë në dosjet penale është vepra penale më e rëndë.</b></p>		

**DOSJET E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE ADMINISTRATIVE**

<b>Nr. i Serisë</b>	<b>Titulli i Serisë së Dosjes</b>	<b>Periudha e Ruajtjes</b>
3-001	Çështje administrative që lidhen me të drejtat e pronës	Përhershëm
3-002	Çështje administrative në fushën e marrëdhënieve të punës	15 vjet
3-003	Çështje administrative për kundërshtim/anulim/shfuqizim akti/vendim administrativ	10 vjet - 15 vjet
3-004	Çështje administrative për pavlefshmëri akti/vendimi administrativ	10 vjet - 15 vjet
3-005	Çështje administrative për kundërshtim të veprimeve përmbarimore	10 vjet
3-006	Çështje administrative për kompensim burgimi të padrejtë	10 vjet – 15 vjet
3-007	Çështje administrative që lidhen me vërtetimin e faktit juridik për elementë të gjendjes civile	10 vjet



**DOSJET E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TREGTARE**

<b>Nr. i Serisë</b>	<b>Titulli i Serisë së Dosjes</b>	<b>Periudha e Ruajtjes</b>
4-001	Kërkesë për deklarim falimentimi Padi për anullim shoqërie Padi shlyerje dëmi të administratorit Padi për përgjegjësi të Këshillit Mbikqyrës Padi për tejkalim kompetencash administrative Padi për mbrojtjen e pronësisë intelektuale	15 vjet - 20 vjet
4-002	Të tjera	5 vjet

**DOSJET E ÇËSHITJEVE GJYQËSORE TË GJYKATËS SË APELIT TË  
DEPOZITUARA NË GJYKATËN E SHKALLËS SE PARË**

<b>Nr. i Serisë</b>	<b>Titulli i Serisë së Dosjes</b>	<b>Periudha e Ruajtjes</b>
5-001	Çështjet e Komisionit Zgjedhor – Nivel Kombëtar dhe Vendor	15 vjet – 20 vjet
5-002	Njohja e dënimeve të gjykatave të huaja	Ruhen për të njëjtën kohë si çështjet me të njëjtin objekt padie si në gjykatat shqiptare
5-003	Urdhër ekzekutimi i vendimit të gjykatës së apelit  Sqarim i vendimeve të gjykatës së apelit	10 vjet - 15 vjet



**DOSJET E MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE**

Dosjet e menaxhimit të çështjeve përdoren për të skeduar veprimet e regjistrimit, të përkohshëm dhe përfundimtare në lidhje me çështjen, për të informuar avokatët, publikun dhe agjensitë shtetërore për paraqitjet në afatin e caktuar dhe për çështje të tjera lidhur me administratën gjyqësore, si dhe për të ruajtur regjistrat e individëve apo subjekteve ligjore që mund të përfshihen në procedimin e çështjeve:

<b>Nr. i Serisë</b>	<b>Titulli i Serisë së Dosjes</b>	<b>Periodha e Ruajtjes</b>
6-001	<b>Regjistrat dhe Indekset përfshirë:</b>	Përhershëm
	Regjistri Themeltar Civil	
	Treguesi Alfabetik i Çështjeve Civile	
	Regjistri i Vendimeve Civile	
	Regjistri i personave, që u është hequr,, kufizuar, ose kthyer zotësia për të vepruar	
	Regjistri i Çështjeve Civile të Ankimuar	
	Regjistri i Vëllimit të Vendimeve Civile	
	Regjistri i Kompanive Tregtare	
	Regjistri i Personave Fizikë	
	Regjistri i Organizatave Jo-Qeveritare	
	Regjistri i Partive Politike	
	Regjistri i Ndërmarrjeve Shtetërore	
	Regjistri i Çështjeve Speciale Civile dhe Penale	
	Regjistri i Provave Materiale	
	Regjistri Themeltar Penal	
	Regjistri Penal Ushtarak	
	Treguesi Alfabetik i Çështjeve Penale	
	Regjistri i Vendimeve Penale	
	Regjistri i Çështjeve të Ankimuar Penale	
	Regjistri i Lirimit me Kusht, i Revokimit të Vendimeve, i Njohjes së Vendimeve të Gjykatave të Huaja	
Regjistri i Masave të Sigurisë		
Regjistri i Vëllimit të Vendimeve Penale		
6-002	Dokumente të çështjes dhe të administratës së gjykatës, si letra drejtuar avokatëve, institucioneve	5 vjet - 10 vjet
6-003	Të dhëna statistikore dhe analiza vjetore të gjykatës	10 vjet
6-004	Raporte statistikore vjetore	Përhershëm
6-005	Akte administrative të lëshuara nga institucione të tjera	10 vjet

<b>Nr. i Serisë</b>	<b>Titulli i Serisë së Dosjes</b>	<b>Periudha e Ruajtjes</b>
	që nuk kanë lidhje me shqyrtimin e çështjeve gjyqësore konkrete (si p.sh. urdhra të Ministrit të Drejtësisë, etj.)	